



Historiku

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) u krijua si njësi e re bazuar në Ligjin Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Neni 103, në Statutin e Universitetit “Aleksandër Xhuvani”, Neni 71 të Kreut X “Sigurimi i Cilësisë, me Vendimin e Bordit të Administrimit Nr 02 datë 22.01.2018 “Për Miratimin e Numrit të Personelit dhe Pagat për të Gjitha Nivelet në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”.

NJSBC kryen dhe vlerëson cilësinë në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”. Kjo, duke u mbështetur në standardet shtetërore të cilësisë dhe në standardet dhe udhëzimet përkatëse të cilësisë në Hapësirën Europiane dhe atë ndërkombëtare të arsimit të lartë.

UE inkurajon pjesëmarrjen e studentëve në jetën institucionale.

Studentët janë pjesëmarrës në KSC në nivel institucional dhe njësie kryesore, si dhe janë pjesë e hartimit të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm Institucional në UE.



Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,

Rruga “Ismail Zyma”, 3001,

tel/fax: +355 54 252 593,

Elbasan, Albania,

www.uniel.edu.al



**NJËSIA E SIGURIMIT
TË BRENDSHËM
TË CILËSISË**

Misioni i NJSBC-së

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, me synim ruajtjen e standardeve të cilësisë në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”.

Zyra e NJSBC-së ka në përbërje të saj personelin si vijon:

Përgjegjësi: zbaton procedurat dhe standardet e përcaktuara me ligj/akt nënligjor ose të hartuara nga institucioni i arsimit të lartë.

Dy specialistë: të cilët kryejnë punën brenda udhëzimeve të përgjithshme lidhur me objektivat dhe afatet e përfundimit të detyrave të caktuara nga përgjegjësi.

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve organizon pyetësorin institucional dhe pyetësorin vlerësues nga studentët për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi në UE.



Bashkëpunimi i NJSBC-së me KSC -në

Komisioni i Përhershëm në Nivel Institucional për Garantimin e Standardeve të Cilësisë të Institucionit dhe Programeve të Studimit është organ kolegjal që kryen funksionin për garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit”.

Ky Komision mbështet, në bashkëpunim me NJSBC-në, organet dhe autoritetet drejtuese të UE-së në hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë, Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë si dhe parashikime të tjetra të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Komisioni harton në bashkëpunim me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, raportin mbi rezultatet dhe gjetjet e pyetësorit institucional dhe pyetësorit për cilësinë e mësimdhënies.



Funksionet dhe Detyrat e NJSBC-së

Mbështet dhe ofron ekspertizë për sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, vlerësim dhe përfshirjen e studentëve në procesin e të nxënit.

Siguron promovimin e kulturës së cilësisë nëpërmjet një vargu të mekanizmave për komunikim.

Planifikon dhe organizon vlerësimin e brendshëm të cilësisë të programeve të studimit.

Evidenton dhe ndjek problematikat e lidhura me cilësinë e mësimdhënies.

Bën vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore dhe kërkimore- shkencore.

Realizon studime për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të studimit.

Organizon dhe ndjek zhvillimin e pyetësorit studentor për cilësinë e mësimdhënies për çdo program studimi.

Organizon dhe ndjek zhvillimin e pyetësorit institucional.

Bën vlerësimin e performancës të personelit akademik.